

TOUCHDOWN with System 4
PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE

Lënda vepruese: Glyphosate

PËRMBAJTJA

Glyphosate: 36 %

Lëndë ndihmëse: 70,1 %

Formulimi: Koncentrat i tretshëm në ujë (SL)

HERBICID SISTEMIK, JO SELEKTIV, PËR LUFTIMIN E TË GJITHA BARËRAVE TË KËQIA NJË E SHUMËVJEÇARE
TË RUHET NË VENDE TË SIGURTA DHE LARG FËMIJËVE.



Deklaratat e rrezikut

H411 Toksik për gjallesat ujore me efekte afatgjata.

MASAT PARAMBROJTËSE

- Të ruhet në vende të sigurta dhe larg fëmijëve.
- Gjatë përdorimit mos hani dhe mos pini lëngje apo duhan.
- Mënjaroni kontaktin me tretësirën spërkatëse dhe frymëmarrjen e mjergullës spërkatëse.
- Gjatë punës vishni pajisjet mbrojtëse.
- Ruajeni larg pijeve dhe ushqimeve për njerëzit dhe kafshët.
- Pas përfundimit të punës lani duart dhe pjesët e ekspozuara të trupit dhe gjithë pajisjet mbrojtëse.
- Menaxhoni ambalazhin bosh sipas rregullave në fuqi.
- Mos ndotni ujrë me preparatin ose me ambalazhin bosh.
- Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, ndiqni udhëzimet për përdorimin e tij.
- Mos ndotni ujrë me preparatin ose me ambalazhin e tij.

UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN:

- **Në rast kontakti me sytë** i lani urgjentisht me ujë të bollshëm. Hiqni lentet e kontaktit nëse është e mundur dhe shpëllajini sërish. Në rast se acarimi vazhdon, mer këshillën ose kujdesin mjekësor.
- **Në rast kontakti me lëkurën** hiqni rrobat e ndotura dhe lahuni urgjentisht me ujë të bollshëm dhe sapun.
- **Në rast gjëllitjeje** mos provokoni të vjella. Dërgoni të sëmurin në spital dhe i tregoni mjekut etiketën. Jepini të

dëmtuarit karbon aktiv të tretur në sasi të mëdha uji. Mos i jepni asgjë personit të prekur nëse ka humbur ndjenjat.

- **Në rast të thithjes të tretësirës spërkatëse me organët e frymëmarrjes**, largoni të aksidentuarin nga zona ku u ekspozua, mbajeni atë të ngrohtë dhe të qetë. Kërkoni këshillë mjekësore.
- **Antidot** specifik nuk ka, mjekimi simptomatik.

Për të mbrojtur bimët jo objekt luftimi në dozat 500-700 ml, lini një zonë mbrojtëse të pa trajtuar prej 5 metrash nga nga toka jo bujqësore dhe përdorni sprucatorë që ulin 75 % krijimin e mjegullës spërkatëse.

PËRDORIMI:

FUSHA E PËRDORIMIT	OBJEKTI I LUFTIMIT	DOZA (ml/dynym)
Vreshtë Ulli Agrume Pemë frutore Toka djerë	-Barërat e këqia njëvjeçare Gjethengushta & Gjethegjëra	150-200
	-Barërat e këqia shumëvjeçare Gjethengushta & Gjethegjëra	500-750
	Krisja (Cynodon dactylon)	750
	Talla (Sorghum halepense)	500
	Truska (Cyperus spp.)	600
	Dredhka e arave (Convolvulus arvensis)	750

Përdoret me spërkatje pas mbirjes, kur barërat e këqia ndodhen në fazën e rritjes intensive dhe kanë arritur gjatësinë 15-30 cm. Zakonisht përdoren 20 - 40 litra/dynym solucion.

MËNYRA E PËRDORIMIT : Me spërkatje gjethore të barërave të këqija me 20-40 litra ujë/dynym duke patur kujdes që pikat e tretësirës spërkatëse të mos vijnë në kontakt me pjesë të ndryshme të kulturave bujqësore.

MËNYRA E PËRGATITJES SË TRETËSIRËS SPËRKATËSE: Mbushni me ujë deri në mes pompën spërkatëse dhe duke vazhduar përzierjen shtoni dozën e produktit. Plotësoni me sasinë tjetër të ujit duke vazhduar përzierjen.

PASTRIMI I MAKINAVE TË SPËRKATJES: Zbrazni plotësisht rezervuarin e pompës spërkatëse. Sigurohuni që të jenë hequr të gjitha gjurmët e preparatit. Shpëlani tre (3) herë me ujë të pastër rezervuarin dhe të gjitha pjesët e makinës spërkatëse.

VËREJTJE:

1. Nuk duhet të spërkatet sipërfaqja gjethore e kulturave. - në kulturat shumëvjeçare spërkatja e barërave të këqija duhet të jetë e drejtuar , duke shmangur kontaktin e pikave të tretësirës spërkatëse me gjethet, lastarët e butë, degëzimet dhe plagët e krasitjes së pa mbyllura.
2. Spërkatja lejohet vetëm në kulturat dy (2) vite pas mbjelljes, në varësi të rritjes së tyre. -Për ullinjtë e tavolines lejohet mbledhja e tyre vetëm nga pema. Trajtimi nuk lejohet mbi ullinjtë e rënë në tokë.
3. Toka e trajtuar me Touchdown S4, mund të mbillet me kultura të tjera vetëm 7-14 ditë pas trajtimit.
4. Mënjanoni përdorimin e tij në toka shumë ranore.
5. Mos spërkatni kur fryn erë. Mos spërkatni nëse pritët shi në 6 orë.
6. Mos spërkatni në formë mjergulle, përdorni sprucatorë të tipit fshesë dhe gjithmonë me presion më të ulët se 2 atm.
7. Të mos ndotet uji i pishëm ose ujitës dhe të eliminohet kontakti me kulturat fqinje të ndjeshme. Në qoftë se ndotet uji për ujitje të mënjanohet ujitja me të.
8. Përdorni teknika të përshtatshme bujqësore në mënyrë që produkti ose toka e spërkatur të mos bien në kontakt me pjesët e ndryshme (frutat, gjethet, lastarët, trungjet, etj.) të kulturave bujqësore dhe veçanërisht pemëve frutore bërthamore.
9. Nuk lejohet kullotja në barërat e këqija të spërkatura.
10. Nuk lejohen spërkatjet me pompa spërkatëse dore për trajtime në sipërfaqe dhe fusha të pa kultivuara pas vjeljes së prodhimeve ose para se të punohet toka për mbjellje.

Menaxhimi i rezistencës:

Formulimi përmban lëndën aktive glyphosate, një herbicid që i përket grupit 9 (më parë G) sipas HRAC.

Përdorni metoda alternative të kontrollit të barërave të këqija (metoda mekanike, masa kultivimi, etj.) kur është e mundur dhe alternoni herbicide me një mënyrë tjetër veprimi për të shmangur zhvillimin e rezistencës ndaj lëndës aktive të formulimit.

Mos hyni në zonën e spërkatur përpara se tretësira spërkatëse të jetë tharë plotësisht në sipërfaqen e gjethore.

SPËRKATJA E FUNDIT PARA VJELJES: 7 ditë

FITOTOKSICITETI: Nuk është fitotoksik kur përdoret sipas rekomandimeve të mësipërme.

Nuk duhet të **PËRZIHET** me pesticide të tjera.

UDHËZIME PËR TËRHEQJEN E SIGURT TË PRODUKTIT DHE PAKETIMIT: Shishet bosh të ambalazhit shpëlahen me ujë nën presion ose shpëlahen tre herë (uji i shpëllarjes hidhet në rezervuarin e pompës spërkatëse) dhe pastaj pasi të jenë shkatërruar paraprakisht duke i shpuar, për të siguruar mos ripërdorimin, të vendosen në pikat e grumbullimit për riciklimin ose rikuperimin e energjisë.

Preparati ruhet në vende të errëta, pa diell dhe pa lagështi, në temperaturë -5 deri në 35 ° C.



Nr dhe data e regjistrimit: 177/2, datë 18.12.2024;

Data e prodhimit: ;

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkeseva të përcaktuara): 3 vjet;

Numri i partise se mallit (serie) ose shenja te tjera identifikuese: ;

Tipi i ambalazhit baze: shishe HDPE (High density polyethylene).

Emri dhe adresa e Aplikantit: Syngenta Crop Protection AG. **Adresa:** Berne, Zvicer.

Emri dhe adresa e Prodhuesit te PMB-se: Syngenta Limited. **Adresa:** Guildford, Surrey GU2 7YH, UK.

Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhimi kryhet ne Republiken e Shqiperise):